



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-1279/23
Kaçanik: 31.01.2023

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1.8 i Udhëzimit Administrativ nr.03/2012 - MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 31 janar 2023,


INFORMOHET

1. Me aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2022, me tekste të mëtejme, Raporti i punës së KKSBB- së për vitin 2022.
2. Në materiali e raportit të përcaktuar si në pikën 1 të kësaj shkrese, janë paraqitur të gjitha takimet të cilat i ka mbajtur KKSBB gjatë vitit 2022, ku është debatuar për situatën e sigurisë në komunën e Kaçanikut si dhe rekomandimet të cilat i kanë nxjerrë ky këshill në takimet e mbajtura.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është, Raporti i punës së KKSBB- së për vitin 2022 si në Lëndën: 01Nr.104/02-1279/23.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)-

01.Nr. zyrtar/ 2023

Raporti i punës së KKSB -së për vitin 2022

Takimi i parë i KKSB për vitin 2022 është mbajt më 22 shkurt 2022, viti të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës ndërsa për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2021.

Sipas Komandantit të Policisë shqetësuese është rritja e rasteve të dhunës në familje që në bazë të të dhënavë kjo dukuri ka pasur ngritje në gjithë vendin.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime :

1. Të shpeshtohen patrullimet e policisë në vendet më të frekuentuara nga njerëzit , për të parandaluar çdo dukuri që prishë rendin dhe qetësinë publike.
2. Të punohet më shumë në parandalimin e dhunës në familje
3. Të ofrohen më shumë programe trajnuese për të rinjtë për të parandaluar dukuritë negative.
4. Një përkujdesje më e shtuar në parandalimin e dëmtimit të pyjeve
5. Të gjendet një alternativë më e mirë e bashkëpunimit të akterëve të sigurisë me qytetarë në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike .

Takimi i dytë i KKSB është mbajtur më 05.05.2022 që është kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve. Rreshter Zija Bela raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve e që sipas tij ka qenë e qetë. Shqetësuese në këtë periudhë kohore ishte dukuria e vjedhjeve por që falë angazhimit të stafit

policorë është arritur që personat që kanë kryer këtë vepër të ju nënshtronen procedurave të drejtësisë .

Në këtë takim si temë diskutimi ishte problemi i qenve endacak si dhe zhurma që po shkaktojnë lokalet e natës, mungesa e trotuareve dhe tema tjera të ndryshme që lidhen me sigurinë qytetare. Për shkak të ndjeshmërisë të temave dhe interesimit të pjesëmarrësve për informata më të hollësishme në këtë takim është ftuar edhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e cila dha më shumë informacione në lidhje me barrierat në rrugë, trajtimin e qenve endacak, zhurma e krijuar nga lokalet e natës dhe tema tjera që ndërlidhen me këtë drejtori.

Rekomandimet e nxjerrura nga ky takim ishin:

1. Të zbatohen kriteret për vendosjen e policëve të shtrirë nëpër rrugë
2. Të gjinden forma për funksionalizimin e kamerave të sigurisë
3. Të hulumtohen vendet që kanë nevojë për vendosjen e shenjave sinjalizuese
4. Të krijohen hapësirat e nevojshme për vend parkingje në qytet
5. Të largohen barrierat në rrugë në pjesët që janë ndërtuar trotuaret
6. Tolerancë zero ndaj atyre që nuk respektojnë rregullat e komunikacionit
7. Të monitorohet puna e kompanive që trajtojnë qentë endacak
8. Të bëhen kërkesa të vazhdueshme në nivelin qendrorë për mirëmbajtjen e magjistrales , sidomos në pjesën e territorit të komunës tonë.
9. Të merren masa ndaj pronarëve të lokaleve që nuk respektojnë orarin e punës ,krijojnë zhurmë dhe që ju shërbejnë pije alkoolike moshës adoleshente.

Më datë **07.06.2022** është mbajtur takimi i tretë i rregullt i KKSBB-së nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës, ndërsa për gjendjen e sigurisë në komunën tonë për periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë ku sipas tij ishte e qetë me përjashtim të disa rasteve që nuk kanë paraqitur rrezikshmëri të lartë.

Rekomandimet e nxjerrura nga ky takim ishin :

- 1.Të kërkohet interpretim ligjor për qarkullimin e motoçikletave me rrymë në komunikacion
- 2.Angazhim edhe më i madh i akterëve të sigurisë në pengimin e përhapjes së dukurisë së përdorimit të narkotikëve
- 3.Mos të hezitohet në adresimin e çështjeve që cenojnë sigurinë qytetare
- 4.Të monitorohet plani i sigurisë nëpër shkolla
- 5.Angazhim shtesë i stafit mësimor në aktivitete edukuese me nxënës nëpër shkolla

- 6.Të përdoret forma e anketimeve online në adresimin e çështjeve të sigurisë
- 7.Të merren masa ndaj atyre që qëllimisht bëjnë zjarrvënje si dhe të veprohet me kohë në implementimin e planit në parandalimin e zjarreve
- 8.Të merren masa ndaj disa organizatorëve që organizojnë marshuta nëpër rrugë me motor e automjete që aq më keq janë pa regjistrim .

Më datë **31.08.2022** KKSBB ka mbajtur mbledhjen e IV-të me radhë , të cilën e ka udhëhequr Kryetari i Komunës ndërsa për situatën e përgjithshme të sigurisë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik. Në këtë mbledhje si temë diskutimi ka qenë lëmoshë kërkuesit nëpër rrugë, përmirësimi i kushteve të punës për shërbimin e zjarrfikësve si dhe preventivat për të parandaluar situatë me rrezikshmëri për qytetarë.

Rekomandimet e nxjerrura nga ky takim ishin :

- 1.Të ngrisim shqetësimin në nivelin qendrorë në lidhje me kushtet jo të mira për punë për njësitin e zjarrfikësve
- 2.Aktivitete të shtuara në parandalimin e dukurisë së dhunës në familje
- 3.Të punohet në preventivë për të parandaluar situatat që sjellin rrezikshmëri për qytetarët
- 4.Të parandalohen rrjetet e organizuara që keqpërdorin lëmosh kërkuesit
- 5.Të punohet më shumë në organizim të aktiviteteve që kanë të bëjnë me Trashëgiminë Kulturore
- 6.Të vendosen shenja orientuese në të gjitha hapësirat e nevojshme të territorit të komunës
- 7.Të intervenohet në sanimin e të gjitha pesetave që janë të hapura

KKSBB mbledhjen e V-të të radhës e ka mbajtë më datë **28.10.2022** të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës ndërsa për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi zv. Komandanti i Policisë në Kaçanik

Temë diskutimi në këtë takim ka qenë krijimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara dhe mobilizimi i institucioneve në përballjen e situatave eventuale në sezonin dimëror.

Nga ky takim kanë dalë këto rekomandime:

- 1.Një përkushtim edhe më i madh në krijimin e kushteve në qasje për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha lëmitë
- 2.Të zhvillohen aktivitete në ngritjen e vetëdijes së shoqërisë në përgjithësi për përkujdesje ndaj personave me aftësi të kufizuara
- 3.Mobilizim i përgjithshëm për evitim të ndonjë situate eventuale gjatë sezonit dimërorë
- 4.Krijimi i qasjes së banorëve në rrugë në rastet kur hapet ndonjë vendpunishte
- 5.Komuniteti të jenë më aktiv në arritjen dhe realizimin e kërkesave të tyre

Mbledhja e fundit e KKSB për vitin 2022 është mbajtë më datë **22.12.2022** nën kryesimin e Nënkyetarit të Komunës , ndërsa për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik.

Në këtë mbledhje krahas sigurisë së përgjithshme në komunën tonë , në veçanti u diskutua për vetëdijesimin e qytetarëve për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknicë dhe u vendosë që të kryhen disa aktivitete duke bërë njoftime publike në web faqën e komunës , në rrjetet sociale dhe nëpër shkolla. Gjithashtu në këtë takim u miratua edhe Plani i Punës së KKSB për vitin 2023.

Rekomandimet e nxjerrura nga ky takim ishin:

- 1.Të zbatohet Ligji 04\L-022 që ndalon përdorimin e mjeteve piroteknicë në hapësira publike
- 2.Të organizohen aktivitete vetdijsuese në parandalimin e përdorimit të pakontrolluar të mjeteve piroteknicë
- 3.Të bëhen funksionale kamerat e sigurisë në qytet.

Monitorues në këto takime ishte përfaqësuesi OSBE-së .

Të gjitha takimet e mbajtura të KKSB gjithashtu janë publikuar në web. faqën e Komunës.

Kaçanik ,më _____

